

## KUSH ËSHTË AVOKATI I POPULLIT

Avokati i Popullit është mekanizëm ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës.

Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar nga ankuesit, apo me iniciativën e vet (ex officio).

## KUSH MUNDET T'I DREJTOHET AVOKATIT TË POPULLIT

Të gjithë personat fizik dhe juridik që pretendojnë se e drejta e tyre për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm është shkelur.

Të gjithë personat fizik dhe juridik që pretendojnë që organet kompetente nuk kanë reaguar lidhur me ankesat e tyre për kufizimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm.

## ZYRAT RAJONALE TË AVOKATIT TË POPULLIT Zyra në Prishtinë

Adresa: Rr. "Migjeni", nr.21, 10000 Prishtinë  
Tel: +383 (0) 38 223 782  
Për ankesa telefononi në numrin:  
080015555 pa pagesë

E-mail: [info.oik@oik-rks.org](mailto:info.oik@oik-rks.org) www: <https://www.oik-rks.org/>  
\*\*\*

### Zyra në Prizren

Adresa: Rr. "Remzi Ademi", p.n.  
Ndërtesa e Administratës Pensionale Regjionale në  
Prizren, kati i III.  
Tel: +383 (0)29 222 138  
\*\*\*

### Zyra në Pejë

Adresa: Rr "Mbretëresha Teutë"  
Nr.59, Kati III, Nr. 3, Ndërtesa e Komunës  
Tel: +383 (0)39 432 931  
\*\*\*

### Zyra në Gjiilan

Adresa: Rr "Bulevardi i Pavarësisë"  
(ish ndërtesa e gjykatës), p.n.  
Tel: +383 (0)280 320 843  
\*\*\*

### Zyra në Ferizaj

Adresa: Ndërtesa e Komunës (kati përdhësë)  
Tel: +383 (0)290 326 032  
\*\*\*

### Zyra në Gjakovë

Adresa: Rr. "Ismail Qemali"  
(ish ndërtesa e Kadastrës)  
Tel: +383 (0)390 327 698  
\*\*\*

### Zyra në Mitrovicë

Adresa: Rr."Afrim Zhitia", p.n.  
Ndërtesa e Administratës Pensionale të Kosovës,  
Kati III, Zyra Nr. 11 dhe 12  
Tel: +383 (0)28 530 138  
\*\*\*

### Nën-zyra, Mitrovicë

Adresa: Rr. "Sami Frashëri" p.n. Lagja e Boshnjakëve,  
Ndërtesa e ZAK në veri të Mitrovicës,  
tel: 00381649560050 // + 383 (0) 45 455 319  
\*\*\*

### Zyra në Graçanicë

Adresa: Rr. "Car Lazari", p.n.  
Mobil: +383 (0) 44 367 719  
Mobil: +383 (0) 44 322 979



Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës  
Institucija Ombudsmana Republike Kosovo  
Ombudsperson Institution of Republic of Kosovo

## INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

# E DREJTA PËR MJEDIS TË SIGURT DHE TË SHËNDETSHËM



## E DREJTA PËR MJEDIS TË SIGURT DHE TË SHËNDETSHËM

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, MBROJTJEN E MJEDISIT e përcakton si parim në të cilin bazohet rendi kushtetues i vendit.

Kushtetuta i obligon të gjithë brenda territorit të Republikës së Kosovës, për ta mbrojtur mjedisin.

Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.

Çdo planifikim hapësinor në Republikën e Kosovës duhet të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar, parakushte për zhvillim social dhe ekonomik, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët.

Është detyrë e shtetit, për të siguruar infrastrukturë rrugore të përshtatshme për lëvizjen e papenguar të këmbësorëve, e poashtu infrastrukturë të veçantë për personat me aftësi të kufizuara.

## KUR MUND TË DREJTOHENI TE AVOKATI I POPULLIT?

Nëse mendoni se e drejta e juaj për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm është duke u kufizuar nga ndotja e ajrit, ujit, tokës, nga zhurma dhe mbeturinat, si rrjedhojë e veprimeve arbitrare të personave të tretë apo edhe nga veprimi apo mosveprimi i autoriteve publike, drejtoheni në Institucionin e Avokatit të Popullit.

## KUSH ËSHTË PËRGJEGJËS PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Përgjegjës për Mbrojtjen e Mjedisit janë personat fizik ose juridik që ushtojnë funksione publike administrative, sipas ligjit, duke përfshirë dhe detyra, aktivitete ose shërbime të veçanta që kanë të bëjnë me mjedisin:

Institucionet Publike të Nivelit Qendror

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Agjencitë e Specializuara

Policia e Kosovës

Komunat

## CILAT JANË PARIMET KYESORE MJEDISORE

### I. PJESEMARRJA E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE

Institucionet e pushtetit publik kanë obligim që përmes proceseve të dëgjimit publik çdo personi në vend t'i sigurojnë dhe t'i garantojnë mundësi që të ndikon në mjedisin që jeton dhe punon.

### II. E DREJTA PËR QASJE NË INFORMACIONE MJEDISORE

Është e drejtë e secilit person fizik ose juridik të informohet nga organet përgjegjëse rregullisht, dhe me kohë, në mënyrë të plotë dhe objektive për gjendjen e mjedisit, si dhe për masat paralajmëruese të shtrirjes së ndotjes që mund të paraqesin rrezik për mjedisin, shëndetin dhe jetën e njeriut.

### III. QASJA NË DREJTËSI

Çdo person juridik ose fizik në rast të kufizimit të së drejtës mjedisore, ka të drejtë t'i drejtohet organit administrativ kompetent dhe gjykatës për t'i mbrojtur të drejtat e veta.

